



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:272018
Datë: 15.01.2025
Numri i dokumentit: 06777856

KA.nr.233/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “ALKO-H&S” SH.P.K., me NUI 811128463, adresa në rrugën “Beqir Kastrati” nr.2 kati i III, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Teki Bokshi avokat nga Gjakova, kundër të paditurës: Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Prishtinë përfaqësuar sipas autorizimit nga avokatura shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit me nr.18/2307/1-ZSP/410/19 i datës 18.08.2019 dhe kompensim te demit në formë të fitimit të humbur në shume prej 300,000.00 euro, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit kryesor publik me datë 19.12.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit me autorizim të paditësit, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur, më datë 15.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET pjesërisht e bazuar**, kërkesëpadia e paditësit “ALKO-H&S” SH.P.K., me NUI 811128463, me seli në Gjakovë, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë.
- II. **ANULOHET** vendimi me nr.18/2307/1-ZSP/410/19 i datës 18.08.2019 si i kundërligjshëm.
- III. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit për kompensim te demit në formë të fitimit të humbur në shume prej 100.000.00 € (njëqind mijë euro), për periudhën 2019 -2020, me kamatë prej 8%, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

- IV. **REFUZOHET** pjesa e kërkesëpadisë për kompensim të dëmit në formë të fitimit të humbur në shume prej 200.000.00 € (dyqind mijë euro), për periudhën 2021 - 2024, si e pabazuar.
- V. Ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar.
- VI. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 04.10.2019, në Gjykatën Themelore të Prishtinës- Departamenti për Çështje Administrative, paditësi “ALKO-H&S” SH.P.K., me seli në Gjakovë ka parashtruar padi e evidentuar ne gjykate me nr. A.2365/19, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit me nr. nr. nr. 18/2307/1-ZSP/410/19 i datës 18.08.2019, me propozim që Gjykata të aprovoj si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, të anuloj vendimin me nr. nr. nr. 18/2307/1-ZSP/410/19 të datës 18.08.2019, si dhe të detyrohet i padituri në kompensimin e dëmit në emër të fitimit të humbur dhe atë për vitin 2018 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2019, e deri në pagesën definitive, për vitin 2019 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2020, për vitin 2020 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2021, për vitin 2021 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2022, për vitin 2022 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2023, e deri në pagesën definitive, për vitin 2024 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2025 e tutje deri në pagesën definitive, në shumë të përgjithshme prej 300,000.00 euro si dhe në kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 233/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit përgatitor më datë 15.08.2023, ndërsa mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik më datë 06.03.2024 pastaj më datë 19.12.2024 konform nenit 41 të LKA-së, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit avokat Teki Bokshi, sipas autorizimit të datës 15.08.2023, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur nga avokatura shtetërore, të ftuar në mënyrë të rregullt, të cilës janë deklaruar për mungesën përmes parashtrësës së datës 19.12.2024, dhe me pjesëmarrje të ekspertës financiare Znj. Adifete Qerimi Begu. Fjala përfundimtare nga paditësi u paraqit me shkrim me date 08.01.2025, e paditura nuk ka parashtruar fjale përfundimtare.

Pretendimet e palës paditëse

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, gjatë shqyrtimit të seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, paditësi me qëllim që të zhvilloj aktivitetin e tij ekonomik, në procedurë të rregullt ligjore ka siguruar licencën e shfrytëzimit me nr. 9963 të datës 01.04.2019 të lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerare (tutje referuar KPMM) dhe Vendimin për Pëlqim Mjedisor me nr. referues 18/2307/1/297/DMU të datës 19.06.2018 lëshuar nga ZSP-MMPH. Akti administrativ i atakuar me padi nuk është konform nenit 47 të LPPA-së ku janë paraparë elementet e cilit do akt administrativ. Konform nenit 52 par 1 nen paragrafi 1.4 i LPPA-së është paraparë që një akt administrativ është i pa ligjshëm nëse është në kundërshtim e dispozitat të cilat rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, andaj vetëm për këtë i njëjti duhet të anulohet. Në këtë çështje duhet pasur parasysh gjithashtu se shfuqizimi i ndonjë akti administrativ nga organi i cili e lëshon mund të bëhet vetëm në bazë të nenit 58 par 2 i ligjit të lartcekur dhe i njëjti mund të bëhet brenda 30 ditëve kur organi publik njihet me rrethanat për të cilat duhet ta anuloj atë, në këtë çështje edhe pse nuk ka pasur rrethana të cilat është dashur te shfuqizohej pëlqimi mjedisor me aktin administrativ të atakuar.
5. Tutje ka shtuar se e paditura ka tejkalar kompetencat e saj kur ka vendosur të shfuqizoj vendimin e atakuar duke pasur parasysh që në bazë të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit

në Mjedis (tutje referuar VNM) e vetmja mënyrë që të shfuqizohet apo anulohet ndonjë vendim i të paditurës është në bazë të nenit 18 par 7 të atij ligji, përkatësisht nëse “ *inspektorati përkatës për çështje mjedisore ka konstatuar se nuk janë realizuar masat e parapara në raportin e VNM dhe kushtet e përcaktuara në vendimin për pëlqimin mjedisor*”. Në bazë të nenit 32 par. 3 të ligjit për VNM e paditura anulon një vendim në rast se janë realizuar të gjitha masat e parapara në raportin e VNM-së. Raporti i vlerësimit e ndikimit në mjedis në bazë të nenit 16 të ligjit për VNM-në në fuqi në atë kohë përpilohet nga ekspert të licencuar. Me vendosjen në këtë çështje e paditur nuk ka ndërmarrë këto masa, nuk ka pasur raport për këtë çështje. Në bazë të nenit 34 te ligjit për VNM-bë vetëm inspektorati është përgjegjës për të gjitha inspektimet e projektit dhe zbatimit të dispozitave të atij ligji dhe jo edhe komuna e Gjakovës e të cilës ka qenë shfuqizimi i aktit administrativ të atakuar. Gjatë seancës përgatitore te datës 15.08.2023 ka theksuar se veprimet e kundërligjshme të paditurës kanë shkaktuar pasoja të konsiderueshme financiare tek paditësi, andaj në këtë çështje për vlerësimin e lartësisë së dëmit për fitimin e humbur nga paditësja dhe dëmet e shkaktuara ka propozuar që te nxirret prova përmes ekspertizës financiare ndërsa përmes parashtrësës së datës 12.12.2024 ka bërë precizimin e padisë në kuptimin objektiv duke i propozuar gjykatës që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “ALKO-H&S” SH.P.K të anulohet vendimin me nr. nr. 18/2307/1-ZSP/410/19 të datës 18.08.2019, si dhe të detyrohet i padituri në kompensimin e dëmit në emër të fitimit të humbur dhe atë për vitin 2018 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2019, e deri në pagesën definitive, për vitin 2019 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2020, për vitin 2020 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2021, për vitin 2021 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2022, për vitin 2022 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2023, e deri në pagesën definitive, për vitin 2024 shumën prej 50,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15 Janar 2025 e tutje deri në pagesën definitive, në shumë të përgjithshme prej 300,000.00 euro, si dhe në kompensimin e shpenzimeve të procedurës,

Kundërshtimet e palës së paditur

6. Përfaqësuesja e të paditurës në pretendimet e dhëna përmes përgjigjes në padi të parashtruar sipas parashtrësës së datës 07.02.2022 ka deklaruar se vendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, ndërsa ajo që pretendon pala paditëse se vendimi i atakuar është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, pasi që pretendimet e saj pala paditëse nuk i ka argumentuar me asnjë provë. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pa bazuar, ndërsa vendimi i të paditurës të mbetet në fuqi.

Provat e administruara

7. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administrua këto prova: Certifikata e regjistrimit të biznesit për paditësin ALKO-H&S SHPK0, Licencë shfrytëzimi me nr.1928/KPMM/2019 në emër të paditësit me nr.Prot:996 me datë 01.04.2019 në kohëzgjatje deri më datë 30.06.2027, Procesverbal me nr.000157 nga Komuna e Gjakovës, Drejtorati për punë inspektuese me datë 08.05.2019, Procesverbal mbi inspektimin e kryer me nr.PV-AK-52/19 me datë 19.06.2019, Njoftim nga Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me datë 07.06.2018 me nr.07-350/01-13056, Kërkesë e paditësit ALKO-H&S për Drejtorinë për Urbanizëm-Gjakovë me datë 08.05.2018, Kërkesa për sqarim lidhur me njoftimin e datës 27.05.2019 e parashtruar nga drejtori i DUMM për MMPH, Vendim me nr.18/2307/1-ZSP/410/19 me datë 14.08.2019 me të cilën shfuqizohet vendimi i pëlqimit mjedisor 18/2307/1-ZSP i datës 19.06.2018, Kërkesë e paditësit për sigurim të vendimit me nr.07/350/1-13056 të datës 13.06.2019, Ankesë e paditësit kundër vendimit 07/350/1-13056 e datës 13.06.2019, Vendim i MMPH-së me nr.18/2307/1-ZSP/177/18 me datë 19.06.2018, Përgjigja nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë me datë 23.09.2019, ndaj kërkesës së kompanisë ALKO-H&S SHPK, Kërkesë e paditësit me datë 19.07.2019 për sqarime lidhur me emërtimin e statusit të zonës, Kontratë për qiranë e tokës pyjore me nr.Ref:KE-176/19 me datë 28.03.2019, Pëlqim i MBPZHR-Agjencia Pyjore e Kosovës me nr. Ref:KE-636/18 me datë 08.10.2018, Çertifikatë e njësisë kadastrale me nr.P-76705057-01984-0, Kopje plani për parcelën 1984-0, Pëlqim i Agjencisë Pyjore e Kosovës me nr.Ref:KE-210/18 me datë 18.04.2018, Shënim zyrtar e dorëzuar nga paditësi, e lëshuar nga Prokuroria Themelore-Gjakovë me nr. PPN/I.94/19 me datë 19.09.2019, Njoftim i datës 06.07.2018 me nr.07-350/01-13056 për ALKO-H&S, Përgjigje nga Kryeinspektori B.H në kërkesën e MMPH-së me nr.2936/19 e datës

- 15.05.2019, Vendim i Drejtorisë për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit me të cilin anulohet vendimi me nr.07/350/01-13056 i datës 07.06.2018, Kërkesë për Ndalim të aktivitetit me datë 10.05.2019, Përgjigje në kërkesë me nr.19/4428/1-685-ZSP/19 me datë 03.09.2019, Ekspertiza financiare e datës 23.08.2024, punuar nga ekspertja financiare Znj. Adifete Qerimi Begu.
8. Nga provat e administruara u vërtetua kjo gjendje faktike: Paditësin ALKO-H&S SHPK, sipas Certifikatës së regjistrimit të biznesit është regjistruar më datë 02.08.2016 me numër të regjistrimit të biznesit 811128463. Me datë 08.05.2018 “ALKO-H&S” SH.P.K, ka parashtruar kërkesë përmes së cilës ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizimit në Gjakovë Ekstraktin nga plani zhvillimor urbanistik për sipërfaqen prej 20.540 m², për shfrytëzim dhe për vendosjen e pajisjes 33563 m², total m i sipërfaqes: 24.103 m² pjesë e parcelës nr. 1984-0.
 9. Agjencia Pyjore e Kosovës ka dhënë pëlqimin me nr.Ref:KE-210/18 me datë 18.04.2018, për pëlqim mjedisor OE ALKO H&S për lejjimin e zhvillimeve të aktiviteteve hulumtuese – hulumtim i rezervave të gurit gëlqeror në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-70705057-01984-0 në sipërfaqe prej 2.22.33 ha, Zona kadastrale Pjetërshan, Komuna e Gjakovës.
 10. Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me njoftim datë 07.06.2018 me nr.07-350/01-13056, pas kërkesës së parashtruar nga aplikuesi “Alko-H&S” SH.P.K pas shqyrtimit të lokacionit ka konstatuar se sipas Planit Zhvillimor Komunal të aprovuar pran Kuvendit Komunal përmes Vendimit me numër 01 Nr. 011-3856/2008 të datës 30.06.2008, kjo zonë është e destinuar si Zonë Malore: hapësirë me prioritet për mbrojtjen e natyrës, ripyllëzim dhe rekreacion. Meqenëse DUMM nuk disponon me Hartën Zonale dhe me ndonjë plan urbanistik më të detajuar për këtë zonë, aplikuesit ALKO-H&S SH.P.K ka bashkangjitur ekstraktin nga Plani Zhvillimor Komunal i Gjakovës, ekstrakt që i ka trajtuar hapësirat në tërësi, ndërsa nuk i ka trajtuar zonat më të vogla në veçanti për çka ka kërkuar sqarim.
 11. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me vendimin nr.18/2307/1-ZSP/177/18 me datë 19.06.2018, përmes këtij vendimi e ka aprovuar kërkesën e Kompanisë “Alko-H&S” SH.P.K., për pëlqim mjedisor për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Pjetërshan, Komuna e Gjakovës, në pjesën e ngastrës

kadastrale nr. P-70705057-01984-0 në sipërfaqe prej 2.22.33 ha, Zona kadastrale Pjetërshan, Komuna e Gjakovës. Pëlqimi mjedisor është i vlefshëm për dy vite (deri me date 19.06.2020).

12. Padiësi me datë 08.10.2018 ka siguruar pëlqimin e MBPZHR Agjencia Pyjore e Kosovës me nr. Ref:KE-636/18, për lejimin e ndërrimit të përkohshëm të destinimit për shfrytëzimin e tokës pyjore te marrë më qira ngastra kadastrale nr. P-70705057-01984-0 në sipërfaqe prej 2.22.33 ha, Zona kadastrale Pjetërshan, Komuna e Gjakovës.
13. Padiës ka lidhur Kontratë për qiranë e tokës pyjore me nr.Ref:KE-176/19 me datë 28.03.2019 me APK- MBPZHR për nje afar prej 5 (pese) vite (kjo nënkupton se kontrata eshte e vlefshme deri me 28.03.2024.
14. Padiësi “ALKO-H&S” SH.P.K., me datë 01.04.2019 nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) është pajisur me Licencë shfrytëzimi me nr.1928/KPMM/2019 me nr.Prot:996 në kohëzgjatje deri më datë 30.06.2027.
15. Komuna e Gjakovës Drejtorati për Punë Inspektuese me datë 08.05.2019 përmes procesverbal me nr.000157, të përpiluar nga inspektorët ka konstatuar se ma realizuara inspektimin bazuar në ankesën e banorëve të fshatit Kusar Komuna e Gjakovës lidhur me fillimin e punimeve për ndërtimin e seperacionit, firma e lartcekur posedon këto dokumente: Vendim për Pëlqim Mjedisor nr. 2307-2/18 të lëshuar më datë 25.06.2018 nga MMPH-ja, Licencë për shfrytëzim me nr. 2539 të datës 01.04.2019 të lëshuar nga KPMM, Kontratë e Agjencionit të Pyjeve të Kosovës i datës 28.03.2019.
16. Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 10.05.2019 padiësit ALKO-H&S i ka lëshuar Kërkesë për Ndalim të aktivitetit me arsyetim se Komuna e Gjakovës ka shpallur tenderin me numër të prokurimit 632-19-2128-5-2-1 dhe numër 632-12-028-521 i datës 11.04.2019 me titull: Shpella e Kusarit Rruga Shenjëzimi, Pastrimi dhe Ndriçim faza e parë, duke kërkuar që urgjentisht organet relevante të anulojnë, shfuqizojnë të gjitha pëlqimet dhe lejet për eksploatim dhe thërrmimin e gurit Gëlqeror në fshatin Kusarë, me qëllim të ruajtjen së natyrës dhe shpellës së fshatit Kusarë.
17. Përgjigje me nr.2936/19 e datës 15.05.2019 në kërkesën e Kryetarit të Komunës së Gjakovës Kryeinspektori në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Bedri Halimi ka njoftuar MMPH-së se OE “Alko-H&S”, SH.P.K, është i pajisur e të gjitha dokumentacionet relevante. Nga Komuna e Gjakovës, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit operatorit i është lëshuar njoftimin më datë 07.06.2018 si përgjigje, ku nuk është precizuar saktë destinimi i kësaj parcele edhe pse kërkesa e operatorit me nr. 08.05.2018 drejtuar Komunës, ka qenë e qartë për vendosjen e një guroreje për eksploitim dhe thërrmim të gurit gëlqeror në parcelën me koordinatat e caktuara. Në bazë të këtij njoftimi të lëshuar nga Komuna, MMPH ka lëshuar Pëlqimin Mjedisor për operatorin, pas debatit publik të mbajtur më datë 06.06.2018 për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ku paraprakisht debati ka qenë i shpallur në gazetë dhe në Komunën. Sa i përket kërkesës për shfuqizimin e dokumenteve të lëshuara nga MMPH-ja në këtë rast Pëlqimit Mjedisor, së pari Komuna duhet të tërheq Njoftimin e lëshuar për operatorin më datë 07.06.2018 dhe të deklarohej se Komuna ose Drejtoria përkatëse nuk jep pëlqim Komunal për operatorin “Alko-H&S”, SH.P.K., për vendosjen e gurores në parcelën me koordinatat e caktuara si dhe nuk do të jep lejen për Ushtrimin e Veprimtarisë (e cila është kusht për marrjen e Lejes Mjedisore, pa të cilën operatori nuk mund të operoj), për instalimin e pajisjeve për operim në parcelën e lartë përmendur, në këtë rast MMPH-ja do të filloj procedurat për tërheqjen e Vendimit për Pëlqim Mjedisor.

18. Me datës 13.06.2019 Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUMM), merr Vendim me të cilin anulohet njoftimi me nr.07/350/01-13056 i datës 07.06.2018, për dhënien e ekstraktit nga Plani Zhvillimor Komunal, në pikën II është specifikuar se pjesë përbërëse e këtij vendimi është përgjigja dhënë kryetarit të Komunës së Gjakovës me Nr. 293.6/19 i datës 15.05.2019 lëshuar nga organi i shkallës së dytë, përkatësisht Kryeinspektori B.H përmes ZSP Ministria e mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në arsyetim të vendimit ka konstatuar se Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, pas shqyrtimit të lokacionit ka konstatuar se sipas Planit Zhvillimor Komunal të aprovuar pran Kuvendit Komunal sipas vendimit me numër 01 Nr.011-3856/2008 të datës 30.06.2008 kjo zonë është e destinuar si Zonë Malore, hapësirë me prioritet për mbrojtjen e natyrës, pyllëzim dhe rekreacion. Aktivitetin të cilin e zhvillon kompania në fjalë është në kundërshtim të plotë me destinimin e kësaj zone sipas PZHK-së sipas të cilit zona ku përfshihet parcela me numër 1984-0 ZK Pjetërshan është e destinuar si zonë malore dhe me qëllim të evitimit të dëmeve të pariparueshme të cilat mund ti shkaktohen komunitetit të kësaj zone dhe interesit publik në përgjithësi. DUMM-ja konsideron se nuk është kompetente për lëshimin e Pëlqimit Mjedisor për Shfrytëzimin, thërrmimin dhe

seperimin ne gurit gëlqeror, Lejes Mjedisore lidhur me këtë aktivitet si dhe akteve të tjera në procedurë të rregullt administrative deri në lëshimin e Lejes ndërtimore, përmes Njoftim të datës 27.05.2019 nga organi kompetent MMPH, i cili ka lëshuar Aktin Administrativ. Vendim për Pëlqim Mjedisor me numër të referencës 18/2307/1-297 DMMU i datës 19.06.2018 ka kërkuar që të ndërmerren veprimet e domosdoshme për evitimin apo kufizimin aty për aty të dëmit.

19. Me Shënim zyrtar të lëshuar nga Prokuroria Themelore-Gjakovë me nr.PPN/I.94/19 me datë 19.09.2019 është konstatuar se pas veprimeve hetimore për kallëzim penal për veprën penale nga Neni 414 të Kodit Penal, nuk ka prova për dyshim të bazuar se OE Alko H&S ka kryer veprën penale.
20. Me Procesverbal mbi inspektimin e kryer me nr.PV-AK-52/19 me datë 19.06.2019, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, inspektorët kanë konstatuar se në kohën e inspektimit biznesi ka poseduar këto dokumente: Certifikata e Biznesit me nr. 81112243 e datës 02.08.2016, Vendimin e Pëlqimit Mjedisor nr18/2307 =/1 258/177 /18 i datës 19.06.2018 Licencë për shfrytëzim me nr. 1771/KPMM/2018 për sipërfaqen me nr. 71479.94 m², Licencë për shfrytëzim me nr.1978/KPMM/2019 për sipërfaqe me nr. 2054027 m². Inspektimi në fjalë është realizuar në bazë të vendimit për anulim njoftimi me numër 07/3050/01-13056 të datës 07.06.2018 lëshuar nga DUMM, sipas kërkesës së aplikuesit “ALKO-H&S SH.P.K., për dhënien e ekstraktit nga Plani Zhvillimor Komunal. Nga masat e shqiptuara është urdhëruar operatori në fjalë që të ndërpres çdo aktivitet të punës bazuar në vendimin e lartcekur.
21. Paditësit ka parashtruar kërkesë me numër 4647/19 të datës 19.07.2019 për sqarime lidhur me emërtimin e statusit të zonës, përmes së cilës kërkesë paditësi kishte kërkuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit që të qartësoj zyrtarisht statusin e parcelës nr. 1984-0 pronë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
22. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me Vendim me nr.18/2307/1-ZSP/410/19 me datë 14.08.2019 shfuqizon vendimin e pëlqimit mjedisor 18/2307/1-ZSP i datës 19.06.2018, për kompaninë “Alko-H&S” SH.P.K., për eksploatimin dhe thërrmimin e gurit gëlqeror, ndërsa kësaj kompanie të lartcekur i është ndaluar çdo

aktivitet për eksploitim dhe thërrmimin e gurit gëlqeror në Pjetërshan Gjakovë, me arsyetim se pas shqyrtimit të kërkesës së kryetarit të Komunës së Gjakovës për ndalimin e eksploatimit dhe thërrmimit të gurit gëlqeror në fshatin Kusarë, Vendimin nga Komuna e Gjakovës për anulimin e njoftimit me numër 07/350/01-13056 të datës 07.06.2018 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit sipas kërkesës së aplikuesi “Alko-H&S” SH.P.K., është vlerësuar se sipas vendimit për tërheqjen e njoftimit të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës, për lokacionin e kompanisë “Alko-H&S”, SH.P.K., MMPH-ja shfuqizon pëlqimin mjedisor Nr. 18/2307/1-ZSP të datës 19.06.2018 i lëshuar nga MMPH-ja.

23. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në përgjigje në kërkesë me nr.19/4428/1-685-ZSP/19 me datë 03.09.2019 ka theksuar se ka shqyrtuar ankesën e palës kuadër vendimit për shfuqizimin e vendimit të pëlqimit mjedisor nr. 18/2307/1-297/DMMU të datës 14.08.2018, duke theksuar se Ministria respekton të gjitha vendimet të cilat janë në Kompetencën e Komunave në këtë rast edhe vendimin për tërheqjen e vendimit të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen të Mjedisit.
24. Në përgjigje ndaj kërkesës së kompanisë ALKO-H&S SHPK, të datës 22.07.2019, Nr. pro. 4647/19 ku është kërkuar verifikimi vendndodhjes së lokacionit gjeografik të parcelës P-70705057-001984-0 ZK Pjetërshan Komuna e Gjakovës, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë me datë 23.09.2019 ka sqaruar se lokacioni i koordinatave gjeografike të ofruara në kërkesë, ndodhet jashtë kufijve aktual të Zonave të mbrojtura të Natyrës.
25. Nga Ekspertiza financiare e datës 23.08.2024, punuar nga ekspertja financiare Znj. Adifete Qerimi Begu, në të cilën është konstatuar se fitimi i humbur i Kompanisë ALKO-H&S” është 50,000.00 euro për çdo vitë, shumëzuar me 6 vite duke filluar nga viti 2018 deri në vitin 2024, në shumë të përgjithshme prej 300.000.00 (treqind mijë) euro. Bazuar në të dhënat e siguruar në dosjen e punuar nga gjykata, respektivisht në planin e shfrytëzimit të paraqitura në tabelën Nr.1, me një sipërfaqe prej 25,000 m³, dhe me një cmim bruto prej 8 euro, kompania mund të prodhoj nga 200,00 euro për çdo vite. Nëse llogaritjet bëhen nga data 07.06.2018 deri më 07.06.2024 atëherë fitimi bruto do të ishte $(6 \times 120,00) = 1,200.000$ euro. Ndërsa kosto e përgjithshme për prodhimin dhe shitjen e lëndës së parë do të ishte $(6 \text{ vite} \times 150,000) = 900,000$ euro. Fitimi neto është: 1,200,000

euro minus koston prej 900,000 euro, do të ishte 300,000 euro. Fitimi neto për sipërfaqe prej 25,000 x2=50,000 për 1 vitë kalendarik. Fitimi për 1 vitë kalenderik prej 50,000 euro shumëzuar me 6 vite (2018-2024) atëherë fitimi i humbur për Alko-H&S, është 50,000x6=300,000.00 euro.

Vlerësimi i gjykatës

26. Gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton: *Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, më të cilat organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik në çështjet administrative.*
27. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar.
28. Gjykata vlerëson se Vendimi i të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me nr.18/2307/1-ZSP/410/19 me datë 14.08.2019 me të cilin shfuqizohet vendimi për pëlqimit mjedisor 18/2307/1-ZSP i datës 19.06.2018, për kompaninë “Alko-H&S” SH.P.K., për eksploatimin dhe thërrmimin e gurit gëlqeror, me arsyetim se pas shqyrtimit të kërkesës së kryetarit të Komunës së Gjakovës për ndalimin e eksploatimit dhe thërrmimit të gurit gëlqeror në fshatin Kusarë, Vendimin nga Komuna e Gjakovës për anulimin e njoftimit me numër 07/350/01-13056 të datës 07.06.2018 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit sipas kërkesës së aplikuesi “Alko-H&S” SH.P.K., është vlerësuar se sipas vendimit për tërheqjen e njoftimit të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës, për lokacionin e kompanisë “Alko-H&S”, SH.P.K., MMPH-ja shfuqizon pëlqimin mjedisor Nr. 18/2307/1-ZSP të datës 19.06.2018 i lëshuar nga MMPH-ja është në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), për shkak se:

- 28.1 Në Nenin 8 i LPP-së përcaktohet Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme paragrafi 1. përcakton *Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme.*
- 28.2 Në Nenin 47 të LPPA-së përcaktohet se Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar *1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; [...] 1.3. pjesën arsyetuese*
- 28.3 Në Nenin 48 të LPPA-së përcaktohet shprehimisht se çka duhet të përmbajë arsyetimi i një akti administrativ me shkrim: *1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.*
29. Gjykata vlerëson se arsyetimi i dhënë në Vendimin e të Paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me nr.18/2307/1-ZSP/410/19 me datë 14.08.2019 është i papranueshëm sepse nuk përmban fare paraqitje dhe shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, nuk përmban as vlerësim të provave dhe nuk përmend asnjë nga shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare për marrjen e vendimit. Arsyetimi i dhënë në vendim se vendimi për pëlqimit mjedisor 18/2307/1-ZSP i datës 19.06.2018, për kompaninë “Alko-H&S” SH.P.K., për eksploatimin dhe thërrmimin e gurit gëlqeror, bëhet me kërkesë të Kryetarit të Komunës së Gjakovës për ndalimin e eksploatimit dhe thërrmimit të gurit gëlqeror në fshatin Kusarë, Vendimin nga Komuna e Gjakovës për anulimin e njoftimit me numër 07/350/01-13056 të datës 07.06.2018 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit sipas kërkesës së aplikuesi “Alko-

H&S” SH.P.K., është i pabazuar në ndonjë dispozitë ligjore nga rezulton se e paditura ka vepruar në kundërshtim me Nenin 8 të LLPA-së sepse ka vepruar/shfuqizuar aktin e ligjshëm në kundërshtim me procedurat administrative dhe pa vërtetuar fare gjendjen faktike.

30. E paditura Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka vepruar në kundërshtim me vendimin nr.18/2307/1-ZSP/177/18 me datë 19.06.2018, me këtë vendim e kishte aprovuar kërkesën e Kompanisë “Alko-H&S” SH.P.K., për pëlqim mjedisor për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në Pjetërshan, Komuna e Gjakovës, në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-70705057-01984-0 në sipërfaqe prej 2.22.33 ha, Zona kadastrale Pjetërshan, Komuna e Gjakovës. Pëlqimi mjedisor është i vlefshëm për dy vite (deri me date 19.06.2020). Pjese përbërëse e vendime ka përcaktuar kushtet qe duhet ti plotësoj paditësi
31. Me vendimin e kundërshtuar me nr.18/2307/1-ZSP/410/19 me datë 14.08.2019 e paditura nuk merr parasysh asnjë nga kriteret në vendimin nr.18/2307/1-ZSP/177/18 të datë 19.06.2018, për të konstatuar nese OE Alko H&S, ka vepruar ne pajtim apo ne kundërshtim me kriteret e percaktuara dhe me raportin e VNM-së. Sipas këtyre kriterëve janë përshkruar rregullat për paditësin si në vijim: *Gjatë punës (procesit teknologjik) duhet të ndërmerren të gjitha masat për evitimin e ndotjes së mjedisit nga mbeturinat ngurta, evitimin nga derdhja e vajrave të makinave, evitimin nga derdhja e karburanteve e posaçërisht gjatë furnizimit të makinave. Të vendoset sistemi gypor për sjelljen e ujit në stabilimentet e thërrmimit dhe seperimit ku lirohet pluhuri, me qëllim të zvogëlimit të sasisë së pluhurit. Të bëhet furnizimi i rregullt me ujë, që përdoret për zvogëlimin e pluhurit, nëpërmjet gypave që do të vendosen në stabilimente. Nëse nuk bëhet zvogëlimi I pluhurit në nivel të duhur, aplikanti duhet të vendos stabilimentet tjera depluhuese (ventilatorët me ciklona dhe filtra). Të bëhet sistemi për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqet operacional, dhe të hapet kanali për rreth minierës me qëllim të mbledhjes së ujërave atmosferike të ndotura, të grumbullohen dhe orientohen në pajimet për trajtimin e ujërave. Të rregullohen pajimet për trajtimin e ujërave nga sipërfaqet operacionale (puset sedimentuese dhe seperatori i vajrave) Të vendosen pajimet adekuate për mbeturina të ngurta dhe lëngëta. Në kohëra të nxehta të bëhet stërpikja e rrugës (pjesa e asfaltar), kohë pas kohë, me ujë, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit gjatë transportin gjithashtu kamionët gjatë transportit të materialit duhet të mbulohen me mbulesë*

adekuate. Pas shfrytëzimit të kryhet ri kultivimi i zonës së shfrytëzuar, duke iu përshtatur projektit për ri kultivimin e karrierës. Aplikanti përpos kushteve të lartshënuara, duhet të u përmbahet edhe kushteve dhe rekomandimeve të paraqitura në raportin e VNM-së. Nëse nuk plotësohen kushtet e lartcekura , pëlqimi do të anulohet (merret).

32. Rrjedhimisht e paditura nuk ka vlerësuar asnjë nga kriteret e përcaktuara me lart dhe si pasojë ka ushtruar diskrecionin duke vepruar në kundërshtim me Neni 4 Parimi i ligjshmërisë ku përcaktohet *1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj. 3. Nëse ligji autorizon organin publik të ushtrojë pushtet diskrecionar në një vendimmarrje, ai do të ushtrohet në mënyrë të ligjshme [...].*
33. Shfuqizimi i aktit të ligjshëm vendimin nr.18/2307/1-ZSP/177/18 të datë 19.06.2018, është në kundërshtim me Nenin 53 të LPPA-së ku përcaktohet procedura dhe efektet e anulimit dhe shfuqizimit *1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj dhe në kundërshtim me Nenin 57 që percakton 1. Një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj, pa rënë kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni. 2. Përpos nëse parashihet ndryshe me ligj, një akt administrativ dobiprurës i ligjshëm, mund të shfuqizohet vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike, dhe kjo nuk do të mund të bëhet në mënyra tjera që do të cenonin më pak të drejtat apo interesat juridike të fituara të palës. 3. Pala përfituese, në rast të shfuqizimit të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, do të ketë të drejtën e kompensimit monetar nëse ka hyrë në marrëdhënie juridiko-civile nga të cilat nuk mund tërhiqet më, apo nga të cilat mund të tërhiqet vetëm duke pësuar dëme, që nuk do të ishte e arsyeshme të kërkohen nga ajo. 4. Masa e kompensimit nuk duhet të tejkalojë interesin e arsyeshëm që ka pala sikur akti i shfuqizuar të vazhdonte të prodhojë pasoja juridike. Pala nuk përfiton kompensim për fitimin e munguar.*

34. Nga provat e administruara rezulton se paditësi pas marrjes se vendimit nr.18/2307/1-ZSP/177/18 të datë 19.06.2018 nga e paditura, tani të shfuqizuar në mënyrë të kundërligjshme, ka hyrë në marrëdhënie juridike civitë për të cilat e paditura fare nuk I ka marrë parasysh faktin që paditësi me datë 08.10.2018 ka siguruar pëlqimin e MBPZHR Agjencia Pyjore e Kosovës me nr. Ref:KE-636/18, për lejjimin e ndërrimit të përkohshem të destinimit për shfrytëzimin e tokës pyjore te marrë më qira ngastra kadastrale nr. P-70705057-01984-0 në sipërfaqe prej 2.22.33 ha, Zona kadastrale Pjetërshan, Komuna e Gjakovës, Paditës ka lidhur Kontratë për qiranë e tokës pyjore me nr.Ref:KE-176/19 me datë 28.03.2019 me APK- MBPZHR për nje afat prej 5 (pese) vite (kjo nënkupton se kontrata eshte e vlefshme deri me 28.03.2024. Sipas Nenit 4.2 shume e përgjithshme e shfrytëzimit te qirasë është 24,103.00 €. Paditësi “ALKO-H&S” SH.P.K., me datë 01.04.2019 nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) është pajisur me Licencë shfrytëzimi me nr.1928/KPMM/2019 me nr.Prot:996 në kohëzgjatje deri më datë 30.06.2027.
35. Gjykata vlerëson se Vendim i të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me nr.18/2307/1-ZSP/410/19 me datë 14.08.2019 është i kundërligjshëm dhe duhet te anulohet dhe konstatohet se vendimi për pëlqimit mjedisor 18/2307/1-ZSP i datës 19.06.2018, për kompaninë “Alko-H&S” SH.P.K., për eksploatimin dhe thërrmimin e gurit gëlqeror ishte i vlefshëm për dy vite nga data e lëshimit deri me datë 19.06.2020.
36. Në kuptim të nenit 46. paragrafi 4 të LKA-së ku përcaktohet se *kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative, sepse ne këtë rast nuk u anulua akti administrativ i kundërshtuar.*
37. Gjykata vlerëson se kërkesëpadia për kompensimi i demit për fitim të humbur është pjesërisht e bazuar në Nenin 137 të Ligjit Nr.04/L – 077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)” dhe neni 173 i LMD-së përcakton se: “1. I dëmtuari

ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur. par. 3. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin”.

38. Kjo për faktin e paditura si pasojë e veprimit të kundërligjshëm ka penguar paditësin të realizoj fitimin e humbur në shumë prej 100.000.00 (njëqind mijë) €, duke llogaritur nga anulimi i njoftimit me numër 07/350/01-13056 të datës 07.06.2018 nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Vendimin nga Komuna e Gjakovës deri ne datën e vlefshmërisë së pëlqimit mjedisor për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-70705057-01984-0 në sipërfaqe prej 2.22.33 ha, Zona kadastrale Pjetërshan, Komuna e Gjakovës të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me vendimin nr.18/2307/1-ZSP/177/18 me datë 19.06.2018, për Kompanininë “Alko-H&S” SH.P.K. me afat të vlefshmërisë për dy vite nga data e lëshimit (deri me date 19.06.2020), sepse nga rrethana që kishte vepruar paditësi në bazë të vendimeve të ligjshme mund te vlerësohej që paditësi ne mënyre te sigurt do ta realizonte fitimi sipas nenit 173 të LMD-së.
39. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadia për kompenzimin e fitimit të humbur për vitin 2021, 2022, 2023 dhe 2024, sepse duke pas parasysh datën e vlefshmërisë së pëlqimit mjedisor për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-70705057-01984-0 në sipërfaqe prej 2.22.33 ha, Zona kadastrale Pjetërshan, Komuna e Gjakovës të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me vendimin nr.18/2307/1-ZSP/177/18 me datë 19.06.2018, për Kompanininë “Alko-H&S” SH.P.K. me afat të vlefshmërisë për dy vite nga data e lëshimit deri me date 19.06.2020, pretendimi për fitimin e humbur pas kësaj periudhe është i pabazuar në neni 173 të LMD-së, sepse pas skadimit të pëlqimit mjedisor për shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-70705057-01984-0 në sipërfaqe prej 2.22.33 ha, Zona kadastrale Pjetërshan, Komuna e Gjakovës të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me vendimin nr.18/2307/1-ZSP/177/18 me datë 19.06.2018, me afat të vlefshmërisë për dy vite nga data e lëshimit (deri me date 19.06.2020), vazhdimi i pëlqimit mjedisor do ti nënshtrohej procedurës së rivlerësimit. Prandaj dëmi i pretenduar

nga paditësi në lidhje me fitimin e humbur ose humbjen e të ardhurave pas afatit të vlefshmërisë së pëlqimit mjedisor nuk është real dhe i sigurt por është një pretendim hipotetik për një rrethanë të ardhshme të pasigurt.

40. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale, gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.233/22, datë 15.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.